



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

02-035/02-784

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të “Caritas Kosova” dhe Komunës së Vitisë nr 02-035/02-248 të datës 26.04.2021, për projektin: Mbështetja profesionale për funksionalizimin e Zyres së Investimeve dhe Mbështetjes së Bizneseve në Komunën e Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 1980.00 € NË EMËR TË BASHKËPUNIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “Mbështetja profesionale për funksionalizimin e Zyres së Investimeve dhe Mbështetjes së Bizneseve në Komunën e Vitisë”

Neni 1

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të Caritas Kosova dhe Komunës së Vitisë, Kryetari i Komunës me këtë vendim ndan shumën prej 1,980.00€ (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjet euro) në emer të realizimit të projekti “Mbështetja profesionale për funksionalizimin e Zyres së Investimeve dhe Mbështetjes së Bizneseve në Komunën e Vitisë”

Neni 2

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2021 nga kategoria për shërbime dhe mallra.
Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të “Caritas Kosova”.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti, më 06.10.2021

Vendimi i dorzohet:
1.Zyres së Kryetarit
2.Zyres se Financave
3.Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

